

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VUSHTRISË
07 Nr./Dr. 4308/26
Nr. I Eq./Br. Nr. -1-
Data / Datimi 28.01.2026
Vendi / Llogari - VUSHTRISË



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

02.Nv.PB47/26 Kryetari
Datë: 28.01.2026



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 43 pika 14 të Statutit të Komunës, si dhe propozimit të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural datë 27.01.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M P E R F O R M I M T Ë K O M I S I O N I T

1. Formohet komisioni për shqyrtim të aplikacioneve për subvencionim të qumështit për fermer të Komunës së Vushtrisë për 6 (gjashtë) mujorin e dytë për vitin 2024.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 2.1 Tefik Maloku, kryesues i komisionit,
 - 2.2 Rabije Zahiti, anëtar,
 - 2.3 Fatmir Feka, anëtar.
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj aplikacionet për subvencionim të qumështit për fermer të Komunës së Vushtrisë, konform thirrjes publike të shpallur nga Komuna për 6 (gjashtë) mujorin e dytë për vitin 2024 si dhe në pajtim me Rregulloren KKV nr. 01/2022 prot. Nr. 157/22, dt. 30 qershor 2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores KKV Nr 03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

2.1 Tefik Maloku, kryesues i komisionit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për BPZHR
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPRTINA VUCITRN
Nr. i Aktit: 01/26
Datë: 07.01.2026
VUSHTRRI - VUCITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, neni 44 paragrafi 1 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës me datën 07.01.2026 merr këtë:

**VENDIM
PËR NGRITJE TË GATISHMËRISË EMERGJENTE**

1. Ngritet gatishmëria emergjente dhe aktivizohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në Komunën e Vushtrrisë për shkak të rrezikimit të qytetarëve dhe të mirave materiale nga vërshimet, pas reshjeve të shiut në paraditën e datës 07.01.2026 në Komunën e Vushtrrisë.
2. Nga banorët me banim përgjatë lumejve të përfshira nga reshjet e mëdha të shiut kërkohet që në rast nevoje të marrin masa për evakuim të familjarëve si dhe vendosjen e tyre në vende të sigurta.
3. Gjithashtu kërkohet nga Kryetarët e Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të rrezikuara nga vërshimet, që të jenë vigjilent, si dhe të përcjellin situatën në terren dhe t'i koordinojnë veprimet me komunitetin dhe Shtabin për Gatishmëri Emergjente të Komunës, për ndërmarrje të masave të duhura për tejkalim me sa më pak pasoja të gjendjes të krijuar nga vërshimet.
4. Ekonomive familjare, bizneseve etj. të cilat i ekspozohen rrezikut nga vërshimet, në rast nevoje të marrin masa për evakuim të familjarëve, bagëtive dhe të mirave materiale.
5. Njësia e Zjarrfikësve dhe QKMF në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë e Kosovës, të jenë në gjendje mobile për intervenim, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve të goditur nga vërshimet si dhe të mirave të tyre materiale.
6. Për çdo rast emergjent qytetarët mund të lajmërohen në këta numra mobil: 045/603645, dhe 044/196814.
7. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.
8. Vendimi të shpallët në mjetet elektronike të informimit publik të komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRIN
02 Nr. / Br. 02/26
Nr. i fq. / Br. sh.
Data: / Datum 07. 01. 2026
VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 5 paragr. 1 pika 1.2 të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012, nenin 44 paragr. 1 të Statutit të komunës, pas gjendjes së krijuar në terren me rastin e vërshimeve nga reshjet e shiut, me dt. 07.01.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIM TË SHTABIT PËR GATISHMËRI EMERGJENTE NË KOMUNËN E VUSHTRISË

- Me qëllim të ndërmarjes së masave për tejkalim të gjendjes së krijuar në terren nga reshjet e shiut, formohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në këtë përbërje:
 - Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës, kryesues i shtabit
 - Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i Komunës, zëv. Kryesues i shtabit
 - Maliq Ferizi, zv.kryesues,
 - Bajram Beqiri, zyrtar në DMSH, anëtar,
 - Benjamin Shala, DSHP, anëtar
 - Reshat Kovaçi, Komandant i Stacionit Policor, anëtar
 - Lorik Maxhuni, DSHS, anëtar,
 - Musaj Tërbunja, zyrtar në Drejtorinë e Ardimit
 - Zyrtari I Drejtorisë për Bujqësi, anëtar
 - Fadil Hyseni, Shef i Nësisë së Zjarrfikësve
 - Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq në Vushtrri, anëtar
 - Përfaqësuesi i KEDS- it, anëtar
 - Shefqet Maloku Menaxheri i KRU Njësia në Vushtrri
 - Përfaqësuesi i Shoqatës së Peshkatarëve në Vushtrri, anëtar
- Bazuar në Planin Komunal për Mbrojtje nga Zjarri Shtabi emergjent duhet të përcjellë 24 orë situatën në terren, dhe koordinoj punët dhe veprimet e tij përmes zyrës komunale për lajmërim, të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, KEDS-in, Ujësjellësin Rajonal " Mitrovica", Njësia në Vushtrri akterë tjerë relevant të ndërlidhur në këto situata emergjente, me qëllim të mbrojtjes së popullatës dhe të mirave materiale nga vërshimet.
- Drejtorët përkatës të drejtorive komunale duhet të ofrojnë mbështetjen e duhur për Qendrën apo ekipet në terren gjatë gjithë kohës sa zgjat gjendja e emergjente si dhe të i kenë në dispozicion në çdo moment të hapur telefonat mobil.
- Kryesuesi i Shtabit Emergjent me ekipin e tij të përcjell situatën në terren dhe sipas nevojës informoj me kohë qytetarët lidhur me gjendjen në terren për të përballuar sa më lehtë dhe pa pasoja situatat emergjente.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Nr. i dokumentit: 2595/26
Kopje / Vendi: - 1 -
Data / Kohë: 19.01.2026
VUSHTRRI - VUCITEN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



02Nr. PB 09 /26
Datë, 19.01.2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 4 pika 6 dhe neni 21 i Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore nenin 43 paragrafi 14 dhe neni 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, nenin 22 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare të Komunës 02Nr. 1546/24 datë 20.09.2024, me propozim të Drejtorisë për Arsim dt. 16 janar 2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES

1. Me këtë vendim formohet komisioni për vlerësim të pasurisë jo financiare - inventarit në institucionet publike arsimore të komunës.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
2.1 z. Valdet Dallku, kryesues i komisionit
2.2 z. Bajram Haziri, anëtar
2.3 z. Bahri Ademi, anëtar
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë vlerësimin e inventarit në institucionet publike të arsimit në Komunën e Vushtrrisë i cili është jashtë përdorimit. Vlerësimi të bëhet konform Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare të Komunës 02Nr. 1546/24 datë 20.09.2024 (neni 22). Komisioni gjatë punës së tij do të bazohet në raportin e komisionit për inventarizim në të cilin janë paraqitë të dhënat për inventarin i cili është jashtë përdorimit dhe i cili duhet të vlerësohet/zhvlerësohet. Raporti (në exel) i Komisionit për inventarizim dhe raportet e detajuara janë në Drejtorinë për Arsim.
4. Komisioni do të fillojë me punë menjëherë dhe do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës me rekomandimet për tjetërsim të inventarit të vlerësuar/zhvlerësuar.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- QSHQ
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - OPŠTINA VUŠTRIA
Nr. / No. 3323/26
-A-
Data / Datum 22.09.2026
VUSHTRI - VUŠTRIA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

02Nr. PB 32/26
Datë, 22.09.2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për shënimin e 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1 znj. Medina Bunjaku, Kryesuese e KO
 - 1.2 znj. Naile Kovaçi Bekteshi, anëtare
 - 1.3 z. Gëzim Saraçi, anëtar
 - 1.4 znj. Florina Krasniqi Mehmeti, anëtare
 - 1.5 z. Fazli Muharremi, anëtar
 - 1.6 z. Driton Vërbovoi, anëtar
 - 1.7 z. Urim Qirezi, anëtar
 - 1.8 z. Fazli Rashica, anëtar
 - 1.9 Përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, anëtarë
 - 1.10 *Blendi Neziri*
2. Mbledhjet e këshillit organizativ do t'i thërret dhe kryesoj Kryesuesi i KO.
3. Këshilli organizativ do të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme për organizim të shënimit në mënyrë sa më solemne të kësaj date të rëndësishme.
4. Kryesuesi i KO do të raportoj te kryetari i komunës për përgatitjet e këtij manifestimi si dhe mbarëvajtjen, pas përfundimit të shënimit të kësaj date.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- QSHQ
- Arkivit

